



Planuar / Doretuar Primiemo/Pradato Received/Delivery	07-07-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinita Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHCK	3976/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.532/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.532/2022 të datës 14.06.2026 të parashtruar nga ankuesi _____ përmes përfaqësuesit të autorizuar, me adresë banimi: _____ kundër organit të punësimit Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike „pezullim parandalues“, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 07.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON PROCEDIMI administrativ lidhur me ankesën A.nr.532/2022 të datës 14.06.2022 të parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar në Komunën e Gjilanit, në pozitën Zyrtar i Gjendjes Civile, Sektori i Gjendjes Civile në kuadër të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme me vendimin e datës 13.05.2022 me nr.315 të kryetarit të Komunës së Gjilanit pezullohet nga puna pa pagesë nga data 06.05.2022 deri më datën 04.06.2022, për shkak të caktimit të masës së paraburgimit prej një (1)muaji.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin me nr.315 të datës13.05.2022 për pezullim sipas detyrës zyrtare të nxjerr nga kryetari i Komunës së Gjilanit, me datën 14.06.2022 ka parashtruar ankesë përmes postës përmes përfaqësuesit të autorizuar me numër protokolli 3479/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 17.06.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Gjilanit. Ndërsa me datë 30.06.2022 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 14.06.2022 me numër protokoll 3479/2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim për pezullim sipas detyrës zyrtare i datës 13.05.2022 me numër 315 i nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Gjilanit; Autorizimi i datës 07.06.2022; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 30.06.2022 me numër protokoll 3823/2022 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/8; Kërkesë e datës 10.05.2022 me nr.02-016/51537 e parashtruar për Kryetarin e Gjykatës Themelore në Gjilan; Përgjigje e datës 12.05.2022 nga Gjykata Themelore në Gjilan; Përgjigje e datës 07.06.2022 nga Gjykata Themelore në Gjilan dhe Kërkesa e datës 06.06.2022 për ofrim të informatës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit, është bërë i pamundur e që rezulton me përfundim të procedimit administrativ, *sepse:*

Duke shqyrtuar ankesën e ankuesit dhe të gjitha provat e lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për objektin e njëjtë të ankesës të ankuesit, me datën 13.05.2022 Kryetari i Komunës së Gjilanit ka nxjerr vendimin me nr.315 për pezullim sipas detyrës zyrtare për ankuesin në pozitën Zyrtar i Gjendjes Civile i cili pezullohet nga puna pa pagesë nga data 06.05.2022 deri më datën 04.06.2022, ndërsa ankuesi ankesën kundër vendimit për pezullim e ka parashtruar me datën 14.06.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i'u referuar dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: „*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë.*” konstaton se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e datës 14.06.2022 të ankuesit është bërë i pamundur sepse për rastin e procedurës së pezullimit të ankuesit nga puna pa pagesë nga data 06.05.2022 deri më datën 04.06.2022, është bërë kundër një akti administrativ i cili nuk ka efekt juridik nga se efekti i këtij vendimi ka qenë deri më datë 04.06.2022 ndërsa ankesën ankuesi e ka dorëzuar në këshill më datë 14.06.2022, andaj duke pasur parasysh se aktet administrative janë të përcaktuara për nga koha sa i përket prodhimit të efektit juridik dhe mbi këtë bazë koha kur është dorëzuar ankesa në këshill është vërtetuar nga provat e lëndës se nuk ka efekt juridik vendimi për pezullim të ankuesit pas datës 04/06/2022 që është objekt i kësaj ankese, ndërsa deri më tani nuk kemi asnjë vendim tjetër të specifikuar që argumenton faktin se kemi ndonjë vendimmarrje tjetër të kryetarit të komunës së Gjilanit apo ndonjë instance tjetër që lidhet me objektin e kësaj ankese dhe që është pretendim i ankuesit sipas kësaj ankese.


Andaj, bazuar në këto rrethana, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi që ankesa e parashtruar nga ankuesi Islam Rashiti të përfundohet procedimi administrativ.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.532/2022, datë 07.07.2022

Sabile AVDYLI



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit,
- ❖ Kryetarit të Komunës së Gjilanit;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së

